




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROJEKT R R E G U L L O R E

**PËR ORARIN E PUNËS DHE MBROJTJEN NGA NDOTJA AKUSTIKE NË SEKTORIN E
GASTRONOMISË**

Prishtinë, 2022

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, nenit 17, pika f dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), duke u bazuar në dispozitat e nenit 5 të Ligjit nr. 02/L-102 për mbrojtje nga zhurma, si dhe mbështetur në pikën a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miratoi këtë

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS DHE MBROJTJEN NGA NDOTJA AKUSTIKE NË SEKTORIN E GASTRONOMISË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet orari i punës për subjektet afariste në sektorin e gastronomisë si dhe parandalimi dhe shmangia e efekteve të dëmshme, duke përfshirë bezdisjen e qytetarëve si rezultat i ekspozimit të zhurmës të krijuar si pasojë e ndotjes akustike nga sektori i gastronomisë brenda kufijve administrativ të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës (mëtej: Kryeqyteti).

Neni 2 Fushëveprimi i Rregullores

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme ndaj të gjitha subjekteve afariste të sektorit të gastronomisë të cilat operojnë në territorin administrativ të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe përkufizimet e mëposhtme për qëllime të kësaj rregulloreje kanë këtë kuptim:

1.1. **Sektori i gastronomisë** - përfshin por nuk kufizohet në subjekte afariste si në vijim: kafene, resturane, bare, klube të natës dhe hapësira të gastronomisë në kuadër të lokaleve që ushtrojnë veprimtari të ndryshme.

1.2. **Zonat** - në të cilat mund të ushtrohet veprimtaria sipas orarit të përcaktuar në këtë Rregullore përfshijnë: zonën urbane, zonën industriale dhe zonën rurale, ashtu siç përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

II. ORARI I PUNËS

Neni 4

Orari i punës në sektorin e gastronomisë

1. Subjektet afariste të sektorit të gastronomisë janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.
2. Orari i punës nënkupton periudhën kohore për fillimin dhe mbarimin e punës.
3. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin ushtrohet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

Neni 5

Periudhat kohore

1. Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:
 - 1.1. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator;
 - 1.2. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars.

Neni 6

Orari i rregullt ditor

1. Orari i punës në *kafene* dhe *restaurane*, pavarësisht zonës, duhet të jetë brenda kornizave kohore:
 - 1.1. periudha verore, prej orës 06:00 – 24:00;
 - 1.2. periudha dimërore, prej orës 07:00 – 24:00.
2. Pavarësisht orarit nga paragrafi 1 i këtij neni, Kryetari i Kryeqytetit me vendim të veçantë mund të lejojë zgjatjen e orarit edhe për 2 (dy) orë shtesë gjatë periudhës 15 korrik – 15 gusht. Gjatë këtyre orëve shtesë decibelët mbesin të njëjtë.
3. Orari i punës në *klube të natës* duhet të jetë brenda kornizave kohore, sipas zonave të caktuara:

3.1. periudha verore, në zonë urbane prej orës 24:00–03:00 dhe në zonë industriale dhe rurale prej orës 24:00–05:00;

3.2. periudha dimërore, në zonë urbane prej orës 23:00–02:00 dhe në zonë industriale dhe rurale prej orës 23:00–04:00

4. Orari i punës në hapësira të gastronomisë në kuadër të subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari të ndryshme (psh. hotele, motele, salla dasmash, pompa të benzinës, qendra rekreative etj.) duhet të jetë brenda kornizave kohore:

3.1. periudha verore, prej orës 06:00-24:00

3.2. periudha dimërore, prej orës 07:00-24:00

5. Përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, subjektet në fjalë mund të punojnë në orare të veçanta sipas kërkesës dhe aprovimit nga organi komunal kompetent.

6. Për qëllime të këtij neni, hapësirat e gastronomisë (hotele, motele etj) të cilat organizojnë ndeja të shoqëruar me muzikë pas orës 24:00 konsiderohen klube nate dhe për to do të aplikohen rregullat për klubin e natës.

Neni 7

Taksa për punën gjatë orarit të natës

1.Subjektet afariste – *klubet e natës*, të cilat sipas kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të punojnë pas orës 24:00 janë të obliguara që të paguajnë taksën vjetore në vlerë prej 10,950 euro.

2.Të gjitha subjektet afariste të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 6, të cilat sipas kësaj Rregulloreje kanë të drejtë të punojnë pas orës 24:00 janë të obliguara që të paguajnë taksën vjetore në vlerë prej 3,650 euro.

1. MASAT MBROJTËSE NGA NDOTJA AKUSTIKE

Neni 8

Masat për mbrojtjen nga ndotja akustike

Me këtë rregullore përcaktohen masat për mbrojtjen nga ndotja akustike duke përfshirë orarin, parametrat e lejuar, mjetet matëse për burimet e ndotjes dhe gjobat në sektorin e gastronomisë në territorin e Kryeqytetit.

Neni 9

Ndotja akustike

Ndotje akustike janë zërat e jashtëm të padëshiruar, të bezdisshëm ose të dëmshëm, të krijuar nga aktivitetet njerëzore duke përfshirë zhurmën e emetuar nga vendet e aktiviteteve të subjekteve afariste që ofrojnë shërbime të gastronomisë.

Neni 10

Indikatorët e zhurmës

1. Burimet e zhurmës janë çdo vibracion i detektuar nga veshi i njeriut, i shkaktuar nga ndonjë mjet apo aktivitet i njeriut.
2. “Lden” - indikator i zhurmës - ditë - mbrëmje - natë, indikator i zhurmës për shqetësimin e përgjithshëm nga zhurma.
3. “Lditë” - indikator i zhurmës gjatë ditës, indikator i zhurmës për shqetësimin nga zhurma gjatë ditës.
4. Lmbrëmje - indikator i zhurmës gjatë mbrëmjes, indikator i zhurmës për shqetësimin nga zhurma gjatë mbrëmjes.
5. Lnatë - indikator i zhurmës gjatë natës, indikator i zhurmës për shqetësimin nga zhurma gjatë natës.

Neni 11

Masat mbrojtëse nga ndotja akustike

1. Me masat e mbrojtjes nga ndotja akustike, pengohet paraqitja e zhurmës, gjegjësisht zvogëlohet zhurma ekzistuese në nivel optimal, deri në masën që nuk shkakton shqetësim për qytetarët.
2. Mbrojtja nga ndotja akustike aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën. Dita zgjatë 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri 19:00, mbrëmja zgjatë 3 orë dhe fillon nga ora 19:00 deri 22:00, kurse nata zgjatë 9 orë dhe fillon nga ora 22:00 deri në ora 07:00 në mëngjes.
3. Të gjitha pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës duhet të mbajnë etiketën CE, shenjën, shkallën e garantuar të fuqisë së zhurmës dhe të jenë të shoqëruara me deklaratën CE të konformitetit.

Neni 12

Pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës

1. Kryeqyteti duhet që ti siguroj pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës të cilat duhet të mbajnë etiketën CE, shenjën, shkallën e garantuar të fuqisë së zhurmës dhe të jenë të shoqëruara me deklaratën CE të konformitetit.
2. Kryeqyteti duhet të krijojë bazën me të dhënat e subjekteve afariste në sektorin e gastronomisë në territorin e saj, në bazë të së cilës do të bëhet shpërndarja e pajisjeve për matjen e nivelit të zhurmës.
3. Në një subjekt afarist, Kryeqyteti duhet të vendosë aq pajisje sa sigurojnë matjen efektive të nivelit të zhurmës nga secili pozicion.

Neni 13

Obligimi për pajisje me certifikatë për nivelin e decibelëve të lejuar

1. Çdo subjekt afarist i sektorit të gastronomisë është i obliguar të pajiset me certifikatë nga Drejtoria përkatëse e shërbimeve publike, dhe me të cilin përcaktohet:
 - 1.1. Niveli i decibelëve të lejuar sipas vlerave të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore;
 - 1.2. Obligimi për vendosjes se pajisjes për matje;
 - 1.3. Taksa e njëhershme në vlerë 180 euro për një pajisje për shpenzimet e pajisjes dhe mirëmbajtjes së saj;
 - 1.4. Koha e fillimit të matjes në pajtim me procedurat si dhe kushtet tjera eventuale të përcaktuara me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Çdo subjekt afarist obligohet që këtë certifikatë ta vendosë në një vend të dukshëm në hapësira të lokalit.

Neni 14

Procedura e aplikimit për certifikatë dhe pajisje për matjen e zhurmës

1. Secili subjekt afarist që hapet i ri pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje duhet të jetë i pajisur me certifikatë dhe pajisje për matjen e zhurmës në momentin e fillimit të punës.
2. Kryeqyteti obligohet që brenda afatit prej 30 ditësh nga koha e aplikimit të subjektit afarist, të pajisë të njëjtin me pajisje/et dhe me certifikatën që përcakton nivelin maksimal të lejuar të zhurmës.

Neni 15

Obligimet e pronarëve të subjekteve afariste

1. Pronarët e lokaleve janë të obliguar që të lejojnë montimin e pajisjeve për matjen e nivelit të zhurmës në hapësirat e subjektit të tyre afarist. Të njëjtët nuk guxojnë ti dëmtojnë apo të marrin veprime të cilat pengojnë këto pajisje që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës.

2. Pronarët e subjekteve afariste në sektorin e gastronomisë duhet të kujdesen që pajisjet për matjen e nivelit të zhurmës të mos dëmtohen nga palët e treta. Përgjegjësinë e dëmtimit nga palët e treta e merr pronari i subjektit afarist.

3. Në rast të ndonjë dëmtimi të pajisjes që të njëjtën e bën jo funksionale, pronari i subjektit afarist obligohet brenda afatit prej 24 orëve të njoftojë Drejtorinë përkatëse për shërbime publike dhe të kërkojë zëvendësimin e pajisjes duke e paguar taksën prej 180 euro për pajisjen e re. Kryeqyteti obligohet që më së largu brenda 72 orësh të vendosë pajisjen e re.

4. Në rast se konstatohet se dëmtimi i pajisjes ka qene i qëllimshëm, pronari i subjektit afarist obligohet brenda afatit prej 24 orëve të njoftojë Drejtorinë përkatëse për shërbime publike dhe të kërkojë zëvendësimin e pajisjes duke e paguar taksën prej 180 euro për pajisjen e re dhe gjobën e përcaktuar në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje. Kryeqyteti obligohet që më së largu brenda 72 orësh të vendosë pajisjen e re.

Neni 16

Përmbajtja e të dhënave të softuerit

1. Pajisja për matjen e zhurmës monitorohet nga një sistem softueri, të dhënat e të cilit do të mbeten pronë intelektuale e Kryeqytetit dhe përdoren në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Softueri duhet të përmbajë dhe t'i ofrojë të dhënat si në vijim:

- 2.1. Nivelin e tejkalar të zhurmës në lokalit përkatës;
- 2.2. Datën dhe kohën e tejkalarimit të nivelit të zhurmës; dhe
- 2.3. Vendin dhe të dhënat e pronarit të lokalit.

3. Softueri duhet të ruaj në kohë reale të dhënat dhe në kohë reale të njoftoj pronarin e lokalit afarist për tejkalarimin e zhurmës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 17
Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës

1. Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës sipas vlerave të përcaktuara në certifikatën e lëshuar për subjektin afarist, përbën shkelje.
2. Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës sipas vlerave të përcaktuara në certifikatën e lëshuar për subjektin afarist duhet të ndodhë në kohë pa ndërprerje mbi 5 minuta që të konsiderohet shkelje.
3. Nëse brenda periudhës 24 orë, tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës përsëritet mbi dy herë edhe në intervale më të shkurta se 5 minuta, gjithashtu konsiderohet shkelje.

Neni 18
Tejkalimi i lejuar për raste të veçanta

Me rastin e plotësimit të nevojave për organizimin e aktiviteteve të veçanta të gastronomisë në hapësira publike, në rastet kur ekzistojnë mundësitë e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, Drejtoria kompetente për Shërbime Publike, mund të lejoj tejkalimin e decibelëve të lejuar, duke caktuar nivelin e decibelëve për atë aktivitet dhe lokacionin e përshtatshëm për qëllime të tilla.

IV. AUTORIZIMET E DREJTORISË SË INSPEKSIONIT

Neni 19

Ndërmarrja e masave dhe veprimeve nga Inspeksioni

1. Drejtoria e Inspeksionit të Kryeqytetit, varësisht nga shkeljet e evidentuara, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, ndërmer masa dhe shqipton gjoba për shkelësit e evidentuar, duke u bazuar në të dhënat që sigurohen nga softueri.

2. Në rastet kur softueri lajmëron ndërprerjen e funksionit të pajisjes, Inspeksioni duhet të vizitojë subjektin afarist për të konstatuar nëse pajisja është dëmtuar qëllimshëm dhe të merr masat dhe veprimet adekuate në rast të konstatimit të shkeljes.

Neni 20

Autorizimet e inspektorit për respektimin e orarit të punës dhe të nivelit të zhurmës

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori i është i autorizuar:
 - 1.1. Të konstatojë shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje, qoftë përmes kontrollit të drejtëpërdrejtë apo përmes të dhënave të cilat sigurohen nga softueri;
 - 1.2. Të urdhëroj ndërmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e shkeljes së konstatuar;
 - 1.3. Të urdhëroj subjektin afarist, përkatësisht personin e autorizuar të të njëjtit, që të respektojë orarin e punës të përcaktuar me këtë rregullore;
 - 1.4. Të urdhëroj subjektin afarist, përkatësisht personin e autorizuar të të njëjtit, që të ndërpresë përdorimin e burimit që shkakton zhurmë përtej nivelit të lejuar të zhurmës;
 - 1.5. Të ndërmarr të gjitha masat ndëshkuese dhe të shqiptojë gjobë për mosrespektim të orarit të punës apo për tejkalim të nivelit të përcaktuar të zhurmës në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

VI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 21 Kundërvajtjet

1. Inspektori i inspektoratit të Kryeqytetit, ka të drejtë që të shqiptoj gjobat në pajtim me legjislacionin në fuqi. Për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje, varësisht nga niveli i shkeljeve dhe në përputhje me rrethanat ku ndodhë shkelja, do të shqipton gjobat në vlerë minimale prej 500 euro dhe në vlerë maksimale prej 5,000 euro, si në vijim:
 - 1.1 Me gjobë prej 500 deri në 2,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili nuk e ka respektuar orarin e përcaktuar të punës të përcaktuar me nenin 6 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2 Me gjobë prej 3,000 deri në 5,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili nuk ka aplikuar dhe rrjedhimisht nuk është pajisur me certifikatën për përcaktimin e nivelit të decibelëve si dhe nuk ka marr pajisjet për matjen e zhurmës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 të kësaj Rregulloreje
 - 1.3 Me gjobë prej 3,000 deri në 5,000 euro do të dënohet pronari i subjektit afarist i cili pengon montimin e pajisjeve për matjen e zhurmës në hapësirat e subjektit afarist apo merr veprime të cilat i pengojnë këto pajisje që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 15 paragrafi 1 i kësaj Rregulloreje;
 - 1.4 Me gjobë prej 3,500 deri në 5,000 euro do të dënohet pronari i subjektit afarist i cili ka dëmtuar qëllimisht pajisjen për matjen e zhurmës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 15 paragrafi 4 i kësaj Rregulloreje.
 - 1.5 Me gjobë prej 1,000 deri në 3,000 euro do të dënohet subjekti afarist i cili ka tejkalluar nivelin e përcaktuar të decibelëve të lejuar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe rrjedhimisht ka shkaktuar zhurmë.
 - 1.6 Me gjobë prej 3,000 deri në 5,000 euro do të dënohet organizatori i aktiviteteve të veçanta të gastronomisë në hapësira publike, i cili ka tejkalluar nivelin e decibelëve të lejuar për aktivitete te veçanta, ashtu siç është përcaktuar me nenin 18 të kësaj Rregulloreje.
2. Në rastet e përsëritjeve të shkeljeve dhe kur Inspektori e vlerëson gjendjen, mund të ndalojë kryerjen e veprimtarisë së caktuar personit fizik apo juridik me urdhëresë, në kohëzgjatje më së shumti prej 8 ditësh.
3. Për të gjitha procedurat e shqiptimit të kundërvajtjeve, mënyrës dhe afateve të pagesës së gjobave si dhe procedurave tjera lidhur me gjobat të cilat nuk janë rregulluar me dispozitat e kësaj Rregulloreje, vlejnjë dispozitat e Ligjit për Kundërvajtjet.

VII. PROCEDURA E ANKESËS

Neni 22

E drejta dhe procedura e ankesës

1. Kundër vendimit të lëshuar nga inspektori, mund të ushtrohet ankesë pranë komisionit për shqyrtimin e ankesave në Kryeqytet, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të aktit administrativ.
2. Procedurat dhe afatet lidhur me trajtimin dhe vendosjen e ankesave nga ana e komisionit për shqyrtimin e ankesave zhvillohen në përputhje me dispozitat e Ligjit së Përgjithshme Administrative.
3. Ankesa e palës e drejtuar në Gjykatën kompetente kundër vendimit të Komisionit nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit të inspektorit.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 23

Dispozitat shfuqizuese dhe kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohen dispozitat e Rregullores për Orarin e Punës si dhe vendimi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës që përcakton orarin e punës për subjektet afariste të gastronomisë që përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, subjektet afariste që janë aktive duhet të aplikojnë brenda afatit prej 15 ditësh pranë Drejtorisë përkatëse të shërbimeve publike në Kryeqytet që të pajisen me certifikatë që përcakton nivelin maksimal të lejuar të decibelëve si dhe me pajisjen për matjen e zhurmës.
3. Kryeqyteti obligohet që brenda afatit prej 30 ditësh të pajisë subjektin afarist me pajisje/t dhe me certifikatën që përcakton nivelin maksimal të lejuar të zhurmës.
4. Prej momentit të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje e deri me 31 mars 2023 konsiderohet periudhë e vetëdijesimit dhe informimit për subjektet afariste si dhe periudhë brenda së cilës subjektet afariste aplikojnë për t'u pajisur me certifikatë dhe pajisje për matjen e zhurmës.

Prandaj, gjatë kësaj periudhe nuk do të aplikohen masat dhe gjobat e parapara me këtë rregullore.

Neni 24 **Shtojcat e Rregullores**

1.Kjo rregullore ka të bashkëngjitura dy shtojca:

- 1.1. Shtojca për ndarjen e zonave urbane, periferike dhe rurale të Kryeqytetit;
- 1.2. Shtojca për vlerat e lejuara të emisioneve të zhurmës; dhe

2. Shtojcat e përcaktuar me këtë nen konsiderohen pjesë përbërëse të Rregullores dhe të njëjtat duhet të zbatohen nga organet e Kryeqytetit dhe nga subjektet afariste të sektorit të gastronomisë.

Neni 25 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

_____, më _____

KRYESUESI I KUVENDIT
